

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.A. dhe G.A., ty dy nga fsh. ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, dhe veprës penale, për secilin veç e veç, mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarin H.A., edhe për vepër penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, për të akuzuarin B.A. nga fsh. ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarin A.K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së, duke vendosur për ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjakovë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. G.K., të dëmtuarit E.B., të mbrojtësit të akuzuarit G.A., av. M.S., të akuzuarit B.A., si dhe përgjigje në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit H.A., av. N.D., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Gjakovë, PKR.nr.79/2017, të dt. 16.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 08.03.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Gjakovë, të dëmtuarit E.B., përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit B.A., si dhe e mbrojtësit të akuzuarit G.A. dhe e të akuzuarit B.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.79/2017, të dt. 16.10.2017, vërtetohet.

Ankesa e të dëmtuarit E.B., për bazat tjera ankimore, hudhet si e palejuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin PKR.nr.79/2017, të dt. 16.10.2017, i ka shpallur fajtorë edhe atë: të akuzuarin G.A., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin H.A., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, dhe të akuzuarin B.A., për shkak

të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar; të akuzuarin G.A., për veprën e parë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilën i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 29.04.2017 deri më datën 16.10.2017, dhe për veprën e dytë penale me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 €, të akuzuarin H.A., me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €, si dhe të akuzuarin B.A., me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €, dënime këto të cilat do të ekzekutohen menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, nëse të akuzuarit refuzojnë t'i paguajnë dënimet me gjobë, atëherë të njëjtat iu zëvendësohen me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim iu llogaritet në shumë prej 20 €.

Të akuzuarit G.A. dhe B.A., i ka obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej nga 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Të akuzuarve iu ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që të akuzuarit G.A., i është konfiskuar pushka automatike AK47, një karikatorë me 93 fishekë dhe 14 gëzhoja, ndërsa, të akuzuarit B.A., i është konfiskuar revolja CZ - Zastava e kalibrit 7,65 m.m dhe dy gëzhoja, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit H.A. dhe A.K., bazuar në dispozitat e nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPPK-së, janë liruar nga akuza e prokurorisë për veprat penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuari H.A., ndërsa, i akuzuari A.K., për veprën penale dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 nën par. 1 të KPK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që me aktakuzë iu vihen në barrë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Gjakovë, për pjesën liruese për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të ligjit penal, ndërsa, për pjesën gjyqësore për shkak të vendimit për dënimin, dhe atë vetëm për të akuzuarit G.A. dhe H.A., me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me të akuzuarit G.A. dhe H.A., ashtu që, të akuzuarve në fjalë t'i u shqiptohen dënime më të ashpra me burgim dhe me gjobë, ndërsa për pjesën liruese, të ndryshohet aktgjykimi, ashtu që të akuzuarit H.A. dhe A.K., t'i shpallë fajtorë dhe t'i u shqiptojë dënime adekuate me shkallën e përgjegjësisë penale ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, kuptohet për veprat për të cilat janë liruar me aktgjykimin e ankimuar

I dëmtuari E.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vendimit për dënim si dhe vendimit për kërkesën pasurore-juridike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.A., av. M.S., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit G.A., t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. av. G.K., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit B.A., t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

I akuzuari B.A., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit B.A., t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka bërë mbrojtësi i të akuzuarit H.A. av. N.D., me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorisë, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën liruese për të akuzuarin H.A., të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i dëmtuari E.B., dhe mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av. N.D., ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokuroria e Apelit, të akuzuarit H.A., G.A., B.A. dhe Albert Kamer dhe as mbrojtësit e tyre av. G.K., av. M.S. dhe av. Prenk Kola. Në seancë e kolegjit i dëmtuari E.B., pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore ngeli në tërësi pranë pretendimeve si në ankesë, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av. N.D., pasi sqaroi po ashtu, disa nga pretendimet në përgjigje të ankesës, i propozoi gjykatës që ta refuzojë ankesën e prokurorisë, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën liruese për të akuzuarin H.A., të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.43/2018, të dt. 29.01.2018, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë, ashtu që, aktgjykimi i ankimuar përkitazi me pjesën liruese të kthehet në rivendosje, ndërsa, përkitazi me pjesën gjyquese të ndryshohet dhe të akuzuarve G.A. dhe H.A., t'iu shqiptohen dënime më të ashpra me burgim dhe me gjobë, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit G.A., të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se:

### **Ankesat nuk janë të bazuara.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, përkitazi me pjesën gjyquese nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit sipas detyrës zyrtare të njëjtën e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konformë dispozitave të nenin 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penal e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimin të ankimuar.

Po ashtu, as gjendja faktike, përkitazi me pjesën gjyquese nuk ka qenë objekt vlerësimi të kësaj gjykate, me qenë se të akuzuarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor e kanë pranuar fajësinë përkitazi veprat penale që janë gjykuar dhe po ashtu, përkitazi me këtë edhe trupi gjyqësor është pajtuar me një pranimi të tillë, prandaj aktgjykimin e ankimuar përkitazi me pjesën gjyquese vlerësojë vetëm në drejtim të pretendimeve ankimor, pra, për vendimin për dënim.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë, të dëmtuarve dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, si dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore –DKR në Gjakovë, përkitazi me këtë bazë ankimore, për të akuzuarin G.A., theksohet se duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore si dhe shkallën e intensitetit të vlerës së mbrojtur, e sidomos duke është marrë parasysh faktin se i akuzuari G.A. ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin edhe më parë, pastaj, se shkalla e dashjes është shumë e lartë, se i akuzuari është i dënuar edhe më parë për vepra tjera penale, atëherë është dashur që të akuzuarin G.A., për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Ndërsa, përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit B.A., av. G.K., përkitazi me këtë bazë ankimore thekson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit G.A., është shumë i butë, sidomos, kur merren parasysh se i akuzuari përveç që ka shtënë në të dëmtuarin B.A., ka rrezikuar njëkohësisht edhe jetën e të dëmtuarit tjetër E.B., pastaj se të dëmtuarin B.A., ka tentuar ta privojë nga jeta edhe një herë më parë dhe atë mu për shkak të hakmarrjes, prandaj edhe propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa, i dëmtuari E.B., në ankesën e tij, përkitazi me këtë bazë ankimore konstaton se në tërësi e aktceptojë fjalën e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit B.A., duke propozuar Gjykatës së Apelit, që të akuzuarit G.A. dhe H.A., t'iu shqiptojë dënim më të ashpër me burgim dhe me gjobë. Pastaj, i akuzuari B.A., në ankesën e tij përkitazi me këtë bazë ankimore konsideron se gjykata e shkallës së parë, gabimisht i ka vlerësuar rrethanat rënduese e duke mos marrë parasysh fare rrethanat lehtësuese, e sidomos faktin se i akuzuari B.A., ka qenë i sulmuar nga i akuzuari G.A. dhe se ditën kritike armën e ka poseduar me qëllim që të mbrohet, gjë që edhe e ka bërë, prandaj, propozon që të akuzuarit B.A., t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, mbrojtësi i të akuzuarit G.A., av. M.S., përkitazi me këtë bazë ankimore konsideron e gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar realisht rrethanat lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë, pastaj, janë mbiçmuar rrethanat rënduese, ngase edhe pse i akuzuari është i dënuar edhe më parë, veprat penale për të cilat është dënuar janë krejt të natyrës dhe llojit tjetër, e që nuk kanë të bëjnë asgjë me veprën penale në fjalë, prandaj, propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të nenit 73 të KPK. Pretendimet e Prokurorisë Themelore DKR në Gjakovë, dhe të dëmtuarve nuk janë të bazuara, ngase, disa nga rrethanat rënduese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, potencohen edhe me ankesë, ndërsa, disa nga rrethanat tjera që potencohen kanë të bëjnë me elementet e veprave penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë, kurse, rrethana tjera nuk janë të asaj rëndësie që do të ndikonin në ashpërsimin e mëtutjeshëm të dënimeve. Ndërsa ato që cekën nga ana e mbrojtësve të akuzuarve si dhe vetë të akuzuarit B.A., janë pothuajse të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysh, e duke marrë parasysh edhe faktin se është fjala për pranim të fajësisë nga ana e të gjithë të akuzuarve, se pastaj, janë marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese të veçanta për secilin të akuzuar veç e veç dhe pikërisht si rezultat i rrethanave në fjalë, me aplikimin e dispozitave për zbutje të dënimit, të parapara sipas dispozitave të nenit 75 dhe 76 të KPK, të gjithë të akuzuarve gjykata e shkallës së parë, iu ka shqiptuar dënimet nën minimumin e paraparë ligjor.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është kryer vepra penale pastaj kontributin e secilit të akuzuar në veprimtarinë inkriminuese të këtyre të akuzuarve, rezulton se dënimet të cilat u ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarve janë të drejta dhe të ligjshme, janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve e po ashtu edhe në funksion të preventivës gjeneralë dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK.

I dëmtuari E.B., në ankesën e tij aktgjykimin e ankimuar e kundërshton edhe për vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike, me të cilin vendim gjykata e shkallës së parë, të dëmtuarin E.B., përkitazi me realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në procedurë kontestimore, mirëpo, në arsyetim përkitazi me këtë nuk thotë asgjë shprehimisht, por, kjo gjykatë vlerësoi se edhe pretendimet në fjalë janë të pabazuara, ngase, në bazë të dispozitave të nenit 463 par. 2 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, mund të vendos që të dëmtuarin ta udhëzojë që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest civil, kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurve për gjykim të plotë apo të pjesshëm të kërkesës në fjalë, prandaj, në rastin konkret përkitazi me kërkesën në fjalë në mënyrë të drejtë është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, për çka edhe në këtë drejtim ankesa e të dëmtuarit është refuzuar si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pati parasysh, po ashtu, edhe bazat tjera ankimore të dëmtuarit E.B., pra, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, por, bazuar në dispozitat e nenit 381 par. 3 të KPPK-së, të njëjtën – pra, ankesën për bazat ankimore në fjalë, e hudhi si të palejuar, ngase, me dispozitat në fjalë parashihet se i dëmtuari mund të paraqesë ankesë ndaj aktgjykimit dhe atë vetëm për vendimin e gjykatës, lidhur me sanksionet penale dhe atë për veprat penale që përfshihen në kapitujt; kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual dhe kundër sigurisë së trafikut publik si dhe tek vendimet mbi shpenzimet e procedurës penale, e që në rastin konkret pasi bëhet fjalë për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, që do të thotë se i dëmtuari ka të drejtë ankesë vetëm përkitazi me vendimin për dënim, e jo edhe për bazat tjera ankimore, prandaj, Gjykata e Apelit, e hudhi ankesën e të dëmtuarit si të palejuar.

Përkitazi me pjesën liruese të aktgjykimit të shkallës së parë, me të cilin aktgjykimin të akuzuarit H.A. dhe A.K., janë liruar nga veprat penale dhe atë; i akuzuari H.A. për vepër penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari A.K. për veprën penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së, Prokuroria Themelore në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur të akuzuarit i ka liruar pa dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare gjegjësisht ato që janë dhënë janë konfuze dhe nuk argumentojnë aktgjykimin lirues, sikur që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, ngase ka pasur prova të mjaftueshme me të cilat pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari H.A. dhe A.K., kanë kryer veprën penale për të cilat edhe janë akuzuar me aktakuzën e prokurorisë, sidomos kur merren parasysh përmbajtja e procesverbalit e shqyrtimit gjyqësor por edhe provave dhe shkresave tjera në lëndë. Sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, gabimisht e mbështet aktgjykimin e sajë në dispozitat e nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPPK-së, duke konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari H.A. e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë në

tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, gjegjësisht i akuzuari A.K., veprën penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së. Në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike i akuzuari G.A., qëllimisht e ka pranuar fajësinë për vepër penale të vrasjes në tentativë, duke ia mundësuar kështu të akuzuarit H.A., që të lirohet përkitazi me këtë vepër penale të kryer në bashkëkryerje, ngase, duke pasur parasysh se ditën kritike kanë qenë që të dy të akuzuarit së bashku në vendin e ngjarjes, gjë që vërtetohet përveç pranimit të fajësisë nga i akuzuari G.A., faktet dhe rrethanat në fjalë vërtetohen edhe nga i dëmtuari B.A., pastaj edhe me provat tjera materiale në shkresat e lëndës, prandaj, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale kur nuk i ka marrë parasysh provat në fjalë dhe e ka liruar të akuzuarin H.A. dhe A.K. për veprat penale që janë akuzuar me aktakuzë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore në fjalë nuk qëndrojnë ngase në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat kanë mbështetje në deklaratat e të dëmtuarve B.A. dhe E.B., por edhe me provat materiale në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi në fjalë është i qartë, konkret dhe nuk përmban kundërtënime me vet veten e as me arsyetimin, në të njëjtin është bërë vlerësimi i provave në mënyrë të drejtë me dispozitat e KPPK, duke paraqitur qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të provuara gjegjësisht si të pa provuara, kështu që në vlerësimin dhe analizën e saj- gjykata e shkallës së parë ka paraqitur të gjitha provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor, duke marrë parasysh edhe provat kundërtënëse dhe lidhur me këtë ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon kjo gjykatë. Kështu, përveç mbrojtjes së të akuzuarit H.A., gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarës, pra, të dëmtuarve B.A. dhe E.B., ku edhe njëri edhe tjetri nuk vërtetojnë se ditën kritike ka qenë edhe i akuzuari H.A., së bashku me të akuzuarin G.A., i cili ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, por jo edhe faktet dhe rrethanat përkitazi me të akuzuarin H.A., pra, se vepra penale në fjalë është kryer në bashkëkryerje. Pastaj, gjykata e shkallës së parë, përveç deklaratës të dy dëshmitarëve okular në vendin e ngjarës, ka marrë parasysh edhe provat materiale në shkresat e lëndës, e duke u bërë analizë të mirëfilltë me deklaratat e të akuzuarve por edhe të dëmtuarve dhe me të drejtë ka konstatuar se nuk është vërtetuar se ditën kritike në vendin e ngjarjes ka qenë edhe i akuzuari H.A., konkludime këto të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe për të akuzuarin A.K., të cilin e ka liruar për vepër penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së, ngase, pasi që nuk është vërtetuar se i akuzuari H.A., ka kryer veprën penale, vrasje në tentativë, atëherë pa dyshim që logjikisht nuk ka pasur mundësi që të kryhet vepra penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2 nën par. 1 të KPRK-së, nga i akuzuari A.K., pasi që ky i fundit akuzohej se i ka dhënë ndihmë të akuzuarit H.A., pas kryerjes së veprës penale.

Prokuroria Themelore, më tej në ankesë pretendon se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se i akuzuari H.A., ka qenë ditën kritike së bashku me dy të akuzuarit tjerë G.A., por gjykata e shkallës së parë, nuk mori fare parasysh faktet dhe rrethanat e vërtetuara nga i dëmtuari B.A., i cili deklaroi se ka dëgjuar zërin e të akuzuarit H.A., kur ka deklaruar “të ndreqa, të ndreqa, e nxora gjakun...”, e që sipas pretendimeve ankimore prezenca e të akuzuarit në vendin e ngjarjes vërtetohet nga dëshmitari B.A., atëherë pa dyshim që të gjitha rrethanat në fjalë qojnë drejtë konkludimit se edhe i akuzuari H.A., ka qenë së bashku me të akuzuarin G.A. dhe e ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar, pra, për vrasje në tentativë e në bashkëkryerje.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore në fjalë nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë, me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk ka vërtetuar se ditën kritike, ishte edhe i akuzuari H.A., në vendin e ngjarjes dhe atë pikërisht duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit B.A., por edhe dëshmitarit – të dëmtuarit tjetër E.B., ku edhe njëri edhe tjetri vërtetojnë se ditën kritike ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tyre i akuzuari G.A., mirëpo, sa i përket personit tjetër as njëri e as tjetri nuk vetëtojnë se ishte në vendin e ngjarjes edhe i akuzuari H.A.. Sipas deklaratave në fjalë, sidomos të dëmtuarit – dëshmitarit E.B., i cili ka deklaruar se të akuzuarin H.A. e nje personalisht dhe me të njëjtin ka bashkëpunuar një kohë të gjatë, përkitazi me ditën kritike ka deklaruar se e ka parë një person tjetër por që nuk e ka njohur dhe se i njëjti nuk ka qenë i akuzuari H.A., të cilin – pra, personin e paidentifikuar e ka përshkruar në detaje, por sërish ka konstatuar se nuk ka qenë i akuzuari H.A., ndërsa, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, i dëmtuari – dëshmitari B.A., ka deklaruar se ditën kritike nuk e ka parë personin tjetër kush ka qenë, mirëpo, ka dëgjuar një zë duke thënë “të ndreqa, të ndreqa, e mora gjakun....”, e që, pra, sipas dëshmitarit mendon se ka qenë i akuzuari H.A., dëshmitar ky i cili konsideron se të akuzuarin e ka njohur për nga zëri. Mirëpo, gjykata e shkallës së parë, duke marrë parasysh deklaratën në fjalë, e duke i krahasuar të njëjtat edhe me provat tjera, e sidomos faktet dhe rrethanat e vërtetuara nga dëshmitari E.B., i cili vërteton se të akuzuarin e ka njohur edhe më parë, dhe se me të njëjtin ka pasur edhe bashkëpunim afarist, dhe se ditën kritike nuk ka qenë personi në fjalë – por i akuzuari, pastaj, deklaratën e dëshmitarit tjetër B.A., se vetëm nga zëri ka menduar se është i akuzuari H.A., por duke e krahasuar distancën nga vendi ku ka qenë i dëmtuari dhe personi i dyshimtë, atëherë, gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se i akuzuari H.A., nuk ka qenë ditën kritike në vendin e ngjarjes, prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me të drejtë gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, të njëjtin e ka liruar nga akuza, mirëpo, dëshmitari i cili e ka njohur mirë edhe më parë të akuzuarin H.A., e me të cilin edhe ka bashkëpunuar më parë, ka thënë se nuk ka qenë i akuzuari H.A., ndërsa, dëshmitari tjetër, edhe pse deklaron se e ka njohur nga zëri të akuzuarin, duke pasur parasysh distancën në mes tyre por edhe faktet dhe rrethanat se i dëmtuari ka qenë i sulmuar dhe se në ndërkohë ka shtënë edhe vetë personalisht në drejtim të personit në fjalë, atëherë nuk rezulton se a ka mundur ta njohë të akuzuarin vetëm për nga zëri. Për arsyerat e cekura më lartë, Gjykata e Apelit, gjeti se ankesa e Prokurorisë, duhet refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë edhe për pikën liruese në drejtim të të akuzuarve H.A. dhe A.K., u vërtetua, për arsyet e cekura më lartë, ndërsa për të akuzuarin A.K., duke u bazuar në faktet dhe rrethanat se pasi që nuk u vërtetua kryerja e veprës penale nga i akuzuari H.A., atëherë, logjikisht nuk ka mundur të kryhet as vepra penale e dhënies së ndihmës.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.36/2018, të dt. 08.03.2018**

**Procesmbajtësi,**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**1. Xhevdet Abazi**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Abdullah Ahmeti**

## 2. Afrim Shala